



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 nën paragrafi d), Nenit 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, si dhe Nenit 40 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Shoqatës së Sindikatës të Pavarur të Administratës Klinë, me nr.Prot. 01Nr.120-27083 të dt.22.10.2020, dhe me rekomandimin e KPF-së të datës 14.10.2020, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën –VII- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur me 30.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

Për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së Sindikatës së Pavarur e Administratës së Komunës së Klinës për pagesën e shujtës në vlerë prej 2.50 € për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës
2. Për implementimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, drejtorja e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, drejtorja për Administratë, duke filluar nga 1 (një) Janari 2020.
3. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës, sipas Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2017 për Procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

- MPL
- Kryetari i Komunës
- Drejtorja e Financave
- Drejtorja e Administratës
- Arkivi

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-31721 2020
Klinë, me 03.11 2020



Kryesuesi,
Fadil GASHI